

Raport mbi veprimtarinë vjetore të investimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme gjatë vitit 2019.

Referuar ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë, vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.56, datë 03.10.2017 për miratimin e rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, neni 18, pika 1, dokumentit “Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, po paraqesim informacionin lidhur me veprimtarinë vjetore investuese për portofolin e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për periudhën Janar - Dhjetor 2019 si vijon:

Në fillim të vitit 2019, Komiteti i Investimeve në zbatim të Politikës e Administrimit të Mjeteve Financiare, miratoi strategjinë e investimit të kontributit vjetor të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2019.

Në vijim të shkresës së Bankës së Shqipërisë në datë 28 shkurt, të gjitha bankat bënë pagesën përkatëse të kontributit të vitit të dytë, në shumën prej 650.081.940 lekë brenda afatit të pagesës dt. 30 prill 2019.

Duke ditur se arkëtimi i kontributit ndodh në një periudhë kohore disa ditore, për të patur një portofol me disa tituj dhe me maturitete të përshkallëzuara është përdorur instrumenti i depozitës një javore pranë Bankës së Shqipërisë. Ky instrument i përdorur gjatë gjithë vitit ka siguruar në të njëjtën kohë të ardhura nga interesi. Niveli mesatar i depozitës ka qenë 176 milionë lekë ose 17% e fondit duke kontribuar edhe në ruajtjen e transhit të likuiditetit.

Në muajin Mars, Komiteti i Investimeve në përputhje dhe në zbatim të politikës së administrimit të mjeteve financiare të FNJ, me qëllim ruajtjen e raporteve sipas monedhës vendosi që të konvertojë përpara arkëtimit të kontributit vjetor kundërvlerën e 240.000 eurove. Për të ruajtur nivelin rregullativ të transhit në valutë, ASD konvertoi edhe 80.000 euro në muajin maj 2019, për të balancuar zhvlerësimin e monedhës Euro në këtë periudhë. Portofoli në valutë prej 600 000 eurosh,

nuk është investuar, por është mbajtur në llogari pranë Bankës së Shqipërisë, sepse nuk ka patur emetime titujsh të Qeverisë Shqiptare në monedhë të huaj gjatë vitit 2019.



Investimet në tituj u bënë në muaj të ndryshëm nga një vit i mëparshëm për të pasur larmi për sa i përket datave të maturimit. Kështu kemi investuar në tituj që maturohen në muajt mars, prill dhe korrik. Për sa i përket afateve të maturimit gjatë vitit 2019 është investuar në tituj me afat maturimi 1, 2 dhe 7 vjeçar.


Në muajin mars është bërë investimi në bono thesari me afat maturimi 12 mujor në shumën prej 150 milion lekë.

Në vijim, pjesa e mbetur e fondit u investua në obligacione të Qeverisë Shqiptare. Në muajin prill në shumën 300 milion lekë me afat maturimi 2 vjeçar, në muajin qershor në shumën 150 milion lekë me afat maturimi 7 vjeçar, dhe në muajin gusht në shumën 170 milion me afat maturimi 2 vjeçar.


Të gjitha investimet në tituj të Qeverisë Shqiptarë janë kryer në tregun primar.

Gjendja e depozitës në fund të vitit është në vlerën 182 milion lekë ndërsa nënportofoli në euro është në vlerën 73 milion lekë.

Në grafikët në vijim paraqitet ndarja e mjeteve financiare të Fondit gjatë vitit 2019, sipas instrumenteve.



Për gjatë të gjithë vitit, Agjencia është kujdesur jo vetëm për një administrim sa më efektiv të fondit, por edhe duke pasur në vëmendje ruajtjen e raporteve sipas transeve dhe monedhës të përcaktuara në politikën dhe strategjinë e investimit.



Norma mesatare e ponderuar e kthimit për portofolin e investuar të FNJ në mbyllje të vitit financiar 2019 është 2.23% për investimet në tituj dhe 0.9% për depozitën.